



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/ 416

Datë: 20.08.2021

Procesverbal

i mbledhjes se -III- (jashtëzakonshme) për vitin 2021 e Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI DITES

1. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvendin e Komunës, Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024

Mbledhja u mbajt me datë: 28.06.2021 duke filluar në ora 13:30, morën pjesë 6 anëtarë të KPF-së, zyra për informim, drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve rëndin e ditës e keni, a ka dikush diçka.
6 anëtarë ishin për rendin e ditës.

Valon Mazreku-Drejtor i drejtorisë për Buxhet dhe Financa: Ne kemi paraqitë KAB-in si një nga dokumentet me të rëndësishme, e kemi punuar si dokument paraprak i qarkores buxhetore. Edhe qarkoren e brendshme e kemi përgatitur përveç që është rritur granti janë rritur edhe të hyrat vetanake mbi 28%. Qarkorja parasheh tri programe ka rritje të granti i Arsimit dhe i Administratës, KAB a përgatitur ty përfshirë edhe objektivat e drejtorive, kemi mi mbajtur disa takime publike, sepse KAB është pjesë e kashit që përfshihen objektivat fiskale dhe zhvillimore.

Alban Krasniqi: Uroj të përgatisim një buxhet të mirë që bashkë këtë vit e mos të përsëriten situata si viteve të kaluara. Ka mund të publikohet të shpallet edhe mbas miratimit të ndodhë procesi i dëgjimeve publike. Te KAB-i e kemi PZhK dhe duhet pajtuar që të jetë si dokument bazë, te plani i veprimit disa gjëra janë të nevojshme të futen në buxhet dhe drejtoritë janë të thirrura në një plan që vetë e kanë bërë. Plani i veprimit nuk përkon me listën e projekteve, sepse situata në teren ka ndryshuar te sigurohemi që shpenzimet të jetë të planifikuara e ne projekte kapitale mos të ketë pa mbulesë. Të përfshihet harta zonale dhe mos të futen projekte që me na ik disa mjete në projekte.

Rrahim Morina: Shumë projekte janë kthyer në mungesë të hartës zonale.

Halil Morina: Këtë vit me herët kemi filluar me buxhetin, duhet me ditë me herët se çka po votojmë.

Rrahim Morina: Duhet me ditë se borxhet janë 2 milion, këtë vit dëgjimet publike duhet mi mbajt bashkë.

Valon Mazreku: Vendimet gjyqësore po na prishin planifikimin buxhetor dhe procedurat e prokurimit.

Rrahim Morina: Kush jeni që KAB-i të rekomandohet për kuvend

Unanimisht ishin për 6 anëtarë.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve, ju falënderoj për pjesëmarrje

Mbledhja përfundoi në ora 14:30.

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip

